



Prishtinë: 20.02.2015

Kodi i ZRRE-së: V_714_2015

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6, neni 14, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L—185);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_1253_11_14**;
- Ankesa e KESCO e datës **13.02.2015**.

në seancën e mbajtur më datë 20 shkurt 2015, nxori këtë:

V E N D I M

- I **REFUZOHET** ankesa e KESCO ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin B. K. (shifra në DPR - 90075891), nga Fushë Kosova, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.
- II **MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK_V_1282_01_15 i datës 13.01.2015.

A r s y e t i m

Departamenti i faturimit në KEK me datë 07.12.2012 i ka dërguar konsumatorit faturën mujore të energjisë elektrike për periudhën nëntor 2012 me **3,960 kWh** apo e shprehur në vlerë financiare **363.89€**, me datë 04.01.2013 i ka dërguar konsumatorit faturën mujore të energjisë elektrike për periudhën dhjetor 2012 me **4,680 kWh** apo e shprehur në vlerë financiare **460.15€** si dhe me datë 03.02.2013 i ka dërguar konsumatorit faturën mujore të energjisë elektrike për periudhën janar 2013 me **2,336 kWh** apo e shprehur në vlerë financiare **216.32€**.

Me datë 04.12.2012 konsumatori ka parashtruar kërkesë zyrtare në KEK për ndërrim njehsori. Me datë 11.01.2013 punëtorët e autorizuar të KEK për ndërrim njehsori kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit, ku kanë larguar nga matja njehsorin elektrik nr. 38610372 me gjendje TL=009933 kWh (tarifa e lartë) dhe TU=003890 kWh (tarifa e ulët), si dhe kanë vendosur për matje njehsorin elektrik nr. 04676719 me gjendje TL=000003 kWh dhe TU= 000007 kWh.

Me datë 21.03.2013 punëtorët e autorizuar të qendrës së kalibrimit kanë bërë shqyrtimin e saktësisë së matjes për njehsorin elektrik nr. 38610372 dhe kanë konstatuar se njehsori elektrik është jashtë kufijve të lejuar të matjes përkatësisht gabimi në matje është **-12.96%**. Pas kësaj departamenti i faturimit në KEDS me datë 04.07.2013 përmes urdhër lejimit nr. 52843DPR-90075891 bazuar në protokollin mbi shqyrtimin e njehsorit elektrik nr. 0004903 të datës 21.03.2013 ka bërë korrigjimin e faturave për periudhën 03/2012 deri më 01/2013 në vlerë **154.19€**.



Me datë 07.08.2013 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KEDS duke kundërshtuar faturimin dhe korrigjimin për shkak të leximit dhe faturimit jo të saktë . Me datë 07.11.2014 Departamenti për Konsumator në KEDS i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar ankesën e tij bazuar në pasqyrën e rrjedhës së energjisë elektrike si dhe protokollit mbi shqyrtimin e njehsorit elektrik nr. 0004903 të datës 21.03.2013.

Konsumatori pas marrjes së përgjigjes së KEDS-it me datë 28.03.2014 ka parashtruar ankesë në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE. DMK pas kësaj ka shqyrtuar ankesën e konsumatorit dhe me datë 13.01.2015 ka nxjerrë vendim duke e **aprovuar** ankesën e konsumatorit dhe duke kërkuar nga KEDS-i që të anulohen faturat nr. 11120DPR-90075891 të datës 07.02.2012, nr. 12120DPR-90075891 të datës 04.01.2013, nr. 0113123833DPR-90075891 të datës 03.02.2013 si dhe korrigjimi nr. 52843DPR-90075891 i datës 04.07.2013, dhe se për këto periudha konsumatori të faturohet bazuar në shpenzimet e regjistruara me njehsorin e ri për periudhat e njëjta (11/2013 me shpenzim prej TL=276 kWh dhe TU=437 kWh, periudha 12/2013 me shpenzim prej TL=370 kWh dhe TU=584 kWh, si dhe periudha 01/2014 me shpenzim prej TL=294 kWh dhe TU=193 kWh).

KESCO në ankesën e saj ka theksuar se është e pakënaqur me vendimin e DMK të ZRRE-së, dhe në ankesë ka atakuar disa çështje. Në ankesë theksohet se vendimi i DMK-së mban datën 13 janar 2015, ndërsa KESCO ka bërë pranimin e këtij vendimi me datë 03 shkurt 2015. Çështje tjetër e theksuar në ankesë është se KESCO në bazë të konstatimit të laboratorit të kalibrimit është konstatuar se saktësia e matjes së njehsorit elektrik është jashtë kufijve të lejuar të matjes, përkatësisht gabimi në matje është (-12.96%), ku në bazë të këtij konstatimi KESCO ka bërë korrigjimin e faturave nga muaji mars 2012 deri në muajin janar 2013 në vlerë financiare prej 154.19€ dhe për këtë DMK e ZRRE-së në vendimin e saj e pranon se korrigjimi është bërë konform dispozitave të Kodit të Matjes përkatësisht nenit 5.11 paragrafi 5.11.1. Dhe krejt në fund KESCO kërkon nga Bordi i ZRRE-së që vendimi i DMK-së të anulohet dhe të urdhëroj ZRRE-në që të përfshijë si duhet në vendim Kodin e Matjes, posaçërisht nenin 5.11 paragrafi 5.11.1.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 20 shkurt 2015 ka analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e konsumatorit, përkatësisht bazën e kundërshtimit të tij në ankesë dhe pas vlerësimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës ka vlerësuar se argumentet e prezantuara nga ana e KESCO nuk janë bindëse.

Sa i përket pikës së parë të kundërshtimit nga ana e KESCO-së se në vendimin e DMK/ZRRE figuron data e nxjerrjes së tij 13.01.2015, ndërsa shpërndarja e tij është bërë me datë 02.02.2015, ndërsa afati kundërshtimit të tij është 14 ditë. Bordi i ZRRE-së lidhur me këtë pikë të kundërshtimit ka konstatuar se pretendimi i KESCO është i pabazë pasi që datat e theksuara në ankesë nuk kanë paraqitur ndonjë pengesë ligjore për atakimin e atij vendimi, kur dihet se afati ligjor rrjedh nga dita kur pala e pranon vendimin dhe në rastin konkret KESCO e ka shfrytëzuar këtë të drejtë pa asnjë pengesë ligjore.

Çështje tjetër e theksuar në ankesë nga KESCO se korrigjimi në vlerë financiare prej 154.19€ është bërë konform nenit 5.11 paragrafi 5.11.1 të Kodit të Matjes dhe se këtë e ka pranuar edhe vet ZRRE. Bordi i ZRRE-së pas vlerësimit dhe analizimit edhe të kësaj pike ka konstatuar se në rastet kur bëhen konstatimet e sakta nga laboratorit kalibrimit është e saktë të veprohet sipas dispozitave ligjore të theksuara më lartë, por që nëse e analizojmë atë çka theksohet në procesverbalin nr. 0004903 të datës 21.03.2013 dhe nëse analizojmë rrjedhën e energjisë elektrike të konsumatorit, ku i njëjti për periudhat 11/2012 dhe 12/2012 si dhe 01/2013 ngarkohet me vlera shumë të larta dhe paushallë del se kemi një kontradiktë në mes këtyre konstatimeve që mund të çojnë në mos besim të plotë të konstatimeve të bëra nga laboratorit i kalibrimit. Andaj me këtë rast Bordi ka konstatuar se DMK me të drejtë ka vepruar në rastin e korrigjimit të këtyre faturave, si dhe për anulimin e korrigjimit të bërë



nga KESCO në vlerë financiare prej 154.19€, pasi që një korrëgjim i tillë ka qenë i pabazë kur dihen saktë shpenzimet që i ka ky konsumator se me njëhisorin e vjetër ashtu edhe me njëhisorin e ri.

Sa i përket çështjes tjetër që theksohet në ankesë nga KESCO ku kërkohet të anulohet vendimi i DMK-së, Bordi i ZRRE-së nuk pajtohet me këtë konstatim pasi që vendimi i atakuar është në përputhje të plotë me rregullat dhe ligjet në fuqi. Bordi ka vlerësuar vendimin e DMK-së si të bazuar, ku shihet se janë bërë analiza të hollësishme me ç'rast janë pasqyruar saktë periodat e shpenzimit të konsumatorit me njëhisor të vjetër dhe njëhisor të ri dhe si i tillë nuk duhet ndryshuar.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 20.02.2015 ka analizuar ankesën e KESCO dhe vendimin e nxjerr nga DMK nr. ZRRE/DMK_V_1282_01_15, dhe pas analizimit të hollësishëm të të gjitha dëshmimeve tjera të prezantuara në shkresat e lëndës ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimin të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Enver Halimi, kryesues

Merita Kostari, anëtare

Krenar Bujupi, anëtar